



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE DIGJITALE

Nr. 8784 prot.

Himarë, më 05.12. 2025

Lënda: Dërgohet për miratim projektvendimi “ Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2026”.

KESHILLIT BASHKIAK HIMARË,

Himarë

Në bazë të pikës 2, të nenit 8, pikës dh, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, (i përditësuar), ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i përditësuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i përditësuar, si dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve Digjitale dhe Drejtoria Juridike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë;

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Projekt vendimin “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2026”.
- Relacion: Mbi projektvendimin “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2026”

KRYETARI

Vangjel Tavo

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZËVENDËSKRYETARI

Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE DIGJITALE

Nr. 8784 prot.

Himarë, më 05.12.2025

PROJEKTVENDIM

Nr. 64 datë, 05.12.2025

**“PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË
BASHKISË HIMARË PËR VITIN 2026”**

Në bazë të pikës 2, të nenit 8, pikës dh, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, (i përditësuar), ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i përditësuar, ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i përditësuar, si dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve Digjitale dhe Drejtoria Juridike, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Himarë;

VENDOSI:

1. Miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë për vitin 2026, i cili do të jetë 333 punonjës.
2. Numri i administratës të Bashkisë Himarë do të jetë 227 dhe numri i punonjësve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike Himarë do të jetë 106.
3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi do të përballohen nga buxheti i Bashkisë Himarë për vitin 2026.
4. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet *Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Informacionit dhe Shërbimeve Digjitale dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.*

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i përditësuar.

KRYETARI I BASHKISË

Vangjel Tavo

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSKRYETARI**

Erifil Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE DIGJITALE

Nr. 8784/12 prot.

Himarë, më 05.12.2025

RELACION:

MBI PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE TË BASHKISË HIMARË PËR VITIN 2026”

Të nderuar Këshilltarë!

Në zbatim të pikës *dh*, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në këtë projektvendim po ju propozojmë për miratim, numrin e përgjithshëm të punonjësve të Bashkisë Himarë, për vitin 2026.

Ky propozim mbështetet në analizën e nevojave reale të strukturës vendore, detyrimeve ligjore, si edhe ngarkesës së shtuar të punës që vjen jo vetëm nga zgjerimi i funksioneve bashkiake, por edhe nga specifikat territoriale dhe sezonaliteti i lartë turistik.

Për vitin 2026, numri total i punonjësve të Bashkisë Himarë propozohet të jetë 333 punonjës. Nga këta, 227 punonjës janë pjesë e strukturës organizative të Bashkisë, ndërsa 106 punonjës me kohë të plotë do të jenë pjesë e “Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike”, një strukturë në varësi të drejtpërdrejtë të bashkisë, e cila mbulon funksione thelbësore të mirëmbajtjes së territorit, pastrimit, gjelbërimit dhe infrastrukturës publike.

Rritja totale prej 14 punonjësish (4 përgjegjës sektori, 7 specialistë, 1 inspektor dhe 2 punonjës pyje-kullota) justifikohet nga nevojat emergjente të sektorëve që përballen me rritje të konsiderueshme të volumit të punës dhe detyrimeve funksionale.

Zona e Himarës është një nga destinacionet turistike më të rëndësishme të vendit, çka sjell rritje të kërkesave për licenca ndërtimi, kontroll territorial, menaxhim më të shpejtë të ankesave, rritje të inspektimeve në terren.

Prandaj propozimi për shtimim e 1 inspektori dhe 2 specialistëve të tjerë është i domosdoshëm për respektimin e ligjit, formalizimin e aktiviteteve ndërtimore, si dhe për menaxhimin e presionit ndërtimor në periudhat intensive.

Gjatë sezonit turistik, Bashkia Himarë përballlet me rritje të ndjeshme të popullsisë rezidente deri në disa herë, çka gjeneron rritje të sasisë së mbetjeve urbane, nevojë për zgjerim të shërbimit të pastrimit, intensifikim të shërbimeve të gjelbërimit, rrugëve dhe plazheve.

Propozimi për shtimin në 106 të punonjësve të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike konsiderohet si një staf i cili minimalisht është i nevojshëm për të garantuar standardet e kërkuara të pastërtisë dhe rendit në territor, sidomos në periudhën Maj–Shtator.

Territori i Himarës ka sipërfaqe të konsiderueshme pyjore e kullotash, të cilat kërkojnë monitorim dhe menaxhim të vazhdueshëm për parandalimin e zjarreve, ruajtjen e biodiversitetit, kontrollin e prerjeve të paligjshme.

Rritja e nivelit të riskut gjatë stinës së verës për shkak të temperaturave të larta dhe fluksit të turistëve e bën të nevojshëm shtimin e 2 punonjësve në këtë sektor.

Rritja e kërkesave për shërbime publike, digjitalizimi i proceseve dhe menaxhimi i programeve të reja me financime të huaja apo qendrore kërkon shtim të kapaciteteve profesionale. Kjo justifikon shtimin e 4 përgjegjësve të sektorëve dhe 3 specialistëve, të domosdoshëm për organizimin efikas dhe monitorimin e funksioneve të deleguara dhe vetjake.

Himara është një nga bashkitë me intensitetin më të lartë turistik në Shqipëri. Ky sezon ndikon në, rritjen e ndjeshme të popullsisë gjatë muajve të sezonit turistik, shtimin e kërkesave për shërbime publike, rritjen e presionit mbi infrastrukturën rrugore, plazhe dhe territor, rritjen e nevojave për kontroll, siguri, rend dhe reagim të menjëhershëm të strukturave bashkiake.

Përballja me këto sfida pa shtimin e forcave njerëzore do të dëmtonte cilësinë e shërbimeve, imazhin turistik të zonës dhe funksionimin normal të bashkisë.

Bazuar në sa më sipër dhe në përgjigje të rritjes së ngarkesës së punës në sektorë kyç, problematikave që paraqesin specifikat territoriale dhe turistike të Bashkisë Himarë, detyrimeve ligjore sipas nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, si dhe nevojën për garantimin e shërbimeve cilësore për qytetarët dhe vizitorët, propozojmë miratimin e numrit të përgjithshëm 333 punonjës, e cila reflekton një shtesë prej 14 punonjësish (nisur nga numri aktual i punonjësve) për vitin 2026. Në total shtohen 14 punonjës të Bashkisë Himarë nga të cilët 4 përgjegjës sektori, 7 specialist, një inspektor dhe dy punonjës të pyje kullotave. Në këtë numër përfshihen 227 punonjës për strukturën organizative të bashkisë dhe 106 punonjës me kohë të plotë për “Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike”, e cila është në varësi të Bashkisë Himarë.

Për të gjitha arsyet e mësipërme, vlerësojmë se miratimi i kësaj strukture është i domosdoshëm, pasi ajo shërben si përgjigje ndaj nevojave reale të strukturës vendore, detyrimeve ligjore, si edhe ngarkesës së shtuar të punës që vjen jo vetëm nga zgjerimi i funksioneve bashkiake, por edhe nga specifikat territoriale dhe sezonaliteti i lartë turistik.

Në këto kushte, kërkojmë miratimin e këtij projektvendimi nga Këshilli i Bashkisë Himarë, duke theksuar gjithashtu gatishmërinë për të reflektuar çdo propozim për ndryshim apo plotësim të kësaj strukture nga ju, të nderuar këshilltarë.

DREJTORIA JURIDIKE

Ardit Muhametaj



DREJTORIA E DBNJISHD

Ergis Papaproko

